



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRIË

PROCESVERBAL
Nga mbledhja e VI-të për vitin 2011, e Kuvendit Komunal në
Vushtrri, mbajtur më 30.6.2011

Mbledhja u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal duke filluar në orën **10:10**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: kryetari i komunës, nënkryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të ICO-së (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit, i cili konstatoi se ka shumicë për punë.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- propozoi që në “të ndryshme” të futen:

- a. Shqyrtimi i propozim-vendimit për transfer të mjeteve buxhetore;
- b. Shqyrtimi i propozim-marrëveshjes, të paraqitur nga OJQ “Grupi Lokal i Veprimit - Vicianarural”;
- c. Shqyrtimi i kërkesës së OJQ “Çeshme” për ndihmë materiale për pjesëmarrje në një festival në Turqi.

Khylsime Feka, anëtare e Kuvendit- kërkoi që në “të ndryshme” të hyn edhe një Informatë, të cilën do ta paraqet në emër të përfaqësueseve femra-deputete të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë.

Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit- propozoi që rendit të ditës t’i shtohet një pikë e posaçme, e që është furnizimi me ujë të pijshëm i qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë. Pastaj tha se në tri kërkesat që i ka bërë në seancën e kaluar, ka marrë përgjigje shumë të mangëta, dhe shtoi se ka kërkuar përgjigje në emër të Grupit parlamentar të LDK-së, kurse përgjigjet i kanë ardhur vetëm atij.

Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të AAK-së propozoi që të futet në rend dite çështja e korrje-shirjeve në Komunën e Vushtrrisë, duke shtuar që jemi në prag të korrjeve. Pastaj lidhur me pyetjet që po parashtrohen nga ana e delegatëve të KK-së, kërkoi që përgjigjet t’iu dërgohen të gjithë anëtarëve të kuvendit, duke kërkuar që përgjigjet duhet të vijnë të plota. Në vazhdim lidhur me

Informatën që do të vjen në seancën e korrikut, kërkoi që ajo informatë të përmbajë përgjigjet edhe lidhur me disa pyetje që janë parashtruar më herët nga anëtarët e kuvendit lidhur me disa probleme në arsim, siç i kemi akoma ato probleme, e ndër to është çështja e emërimit të drejtorëve nëpër shkolla, duke përmendur si shembull rastin kur një profesor i gjimnazit në të njëjtën kohë e kryen detyrën e drejtorit në një shkollë tjetër, kurse rrogën e merr në gjimnaz. Gjithashtu në emër të Grupit parlamentar të AAK-së kërkoi që të diskutohet se a ka mundësi qeveria komunale (drejtoritë përkatëse) me kompaninë e ujësjellësit ta bëjnë furnizimin me ujë të pijshëm për disa zona rurale që nuk kanë ujë fare, ose disa lagje në qytet, së paku në muajt korrik dhe gusht, duke shtuar që në gusht është edhe muaji i shenjtë i Ramazanit, dhe për këto arsye kërkoi që të ndërmerret diçka në përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm për qytetarët e komunës tonë, duke propozuar që edhe përmes “cisternave” të furnizohen banorët e Komunës së Vushtrrisë me ujë.

Ergin Sunguri, anëtar i Kuvendit- lidhur me kërkesën e paraqitur nga OJQ “Çeshme”, tha se qëllimi i vizitës në Turqi është pjesëmarrja në një festival, që do të realizohet bashkarisht me ansamblin “Hasan Prishtina”, duke shtuar se në Turqi do të qëndrojnë 10 ditë.

Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit- paraqiti shqetësimin se në rrugët e fshatrave të Ortakollit, në pjesën nën hekurudhë kanë filluar ndërtime pa kriter, pa leje, në ara të bukës, dhe aty ku janë kanalet e ujitjes, prandaj kërkoi nga ekzekutivi dhe kuvendi i komunës që të ndërmerret masa dhe të ndalohen ndërtimet pa leje. Gjithashtu, shtoi që është një kontrast, pasi që në mesin e plantacioneve me patate ndërtohet, duke u vendosur materiale inerte, të cilat e shëmtojnë atë pjesë të natyrës, duke propozuar që menjëherë t’i ipet një urdhëresë Drejtorisë së Inspektionit dhe dikasterit për bujqësi për të stopuar punimet dhe të anulohen të gjitha ndërtimet pa kriter.

Besim Jashari, anëtar i Kuvendit- duke iu referuar rendit të ditës, lidhur me pikën nr. 9, tha se nuk mund të shënohet festa më herët, kurse sot të shqyrtohet në kuvend kërkesa e shoqatës në fjalë për ndihmë financiare, duke shtuar se kishte me qenë mirë që Shoqata e Veteranëve të luftës së UÇK-së me kohë ta bënte kërkesën në Kuvend, dhe në këtë mënyrë kuvendi në afatin optimal ta aprovonte kërkesën e tyre. Në vazhdim tha se shumë herë janë marrë vendime për dhënien në shfrytëzim të pronave të komunës, por shtoi se ekzekutivi do të duhej që në agjendën e kuvendit të paraqes pika të rendit të ditës, edhe pa kërkuar anëtarët e kuvendit, duke përmendur si shembull çështjen e zënies së tokave bujqësore, dhe shtoi se bazuar në raportin e paraqitur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural del se Komuna e Vushtrrisë prinë me zënien e tokës bujqësore. Pastaj çështja e shëndetit publik është çështje që duhet të debatohet në kuvend, poashtu edhe çështja e arsimit.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- lidhur me mjetet financiare që i ka kërkuar OVL e UÇK-së, tha se kërkesa ka ardhur si propozim pasi që është aprovuar rendi i ditës në KPF, dhe duke e respektuar Rregulloren që thotë se pasi që të aprovohet rendi i ditës nuk ka pika shtesë, kërkesa në fjalë ka mbetur të shqyrtohet në kuvend, duke shtuar se kërkesën e kanë bërë më datën 21.06.2011. Në vazhdim propozoi që rendit të ditës, përveç propozimeve të tij të mëparshme, t’i shtohen edhe këto pika të veçanta: Informatë rreth furnizimit me ujë të pijshëm për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë; Informatë rreth përgatitjeve për korrje-shirjet në Komunën e Vushtrrisë. Pastaj lidhur me pyetjet që po paraqiten nga anëtarët e kuvendit, propozoi që Sekretaria e Kuvendit të përgatit një listë në të cilën do të shënohen emailat e anëtarëve të kuvendit dhe përmes emailave të dërgohen përgjigjet lidhur me pyetjet e parashtruara.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- lidhur me shqetësimin e ngritur nga S.Kadriu, sqaroi se Drejtoria e Inspektionit i ka identifikuar vendet e cekura nga deputeti në fjalë dhe ato punime duhet të eliminohen.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi në mënyrë unanime aprovoi këtë:

R E N D I T E

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.**
- 2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për realizim të projekteve nga mjetet e fondit të USAID-it.**
- 3. Shqyrtimi i Qarkores Buxhetore 01/12, Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB).**
- 4. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për shërbimin me “merimangë” për territorin e Komunës së Vushtrrisë.**
- 5. Shqyrtimi i propozim-vendimeve për ridestinim të mjeteve buxhetore të komunës nga:**
 - a. Projekti “Rregullimi i kanalizimeve” në shumën prej 25.000 €;**
 - b. Projektet kapitale 2011 të komunës në shumën prej 128.480 €;**
 - c. Projektet kapitale në rr. “Dëshmorët e Kombit” në shumën prej 100.000 €;**
 - ç. Projektet kapitale “Blegtori, pemëtari dhe perimkulturë” në shumën prej 7.000 €.**
- 6. Shqyrtimi i petitionit nga banorët e fshatit Begaj të Komunës së Vushtrrisë.**
- 7. Shqyrtimi i propozimit për anulim të vendimit të Kuvendit të Komunës.**
- 8. Shqyrtimi i propozimeve të ZLK-së për emërimin e anëtarëve shtesë të Komitetit për Komunitete.**
- 9. Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë financiare në vlerë prej 5.000 € veteranëve të luftës së UÇK-së për shënimin e 28 qershorit, ditës së themelimit të Brigadës-Zona Operative e Shalës.**
- 10. Shqyrtimi i Informatës rreth furnizimit me ujë të pijshëm për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë.**
- 11. Shqyrtimi i Informatës rreth përgatitjeve të Komunës së Vushtrrisë për korrje-shirjet.**
- 12. Të ndryshme:**
 - a. Shqyrtimi i propozim-vendimit për transfer të mjeteve buxhetore;**
 - b. Shqyrtimi i propozim-marrëveshjes, të paraqitur nga OJQ “Grupi Lokal i Veprimtari - Vicianarural”;**
 - c. Shqyrtimi i kërkesës së OJQ “Çeshme” për ndihmë materiale për pjesëmarrje në një festival në Turqi;**
 - ç. Informatë në emër të përfaqësuesve femra-deputete të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë.**
 - d. Pyetjet eventuale të anëtarëve të Kuvendit.**

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.**

Aprovohet në mënyrë unanime procesverbali i mbledhjes paraprake të Kuvendit të Komunës, pa vërejtje dhe sugjerime.

- 2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për realizim të projekteve nga mjetet e fondit të USAID-it.**

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- njoftoi se Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë ka fituar një grant nga USAID-i për transparencë dhe për punën efikase të kuvendit në fjalë, me ç’rast Kuvendit Komunal të Vushtrrisë iu janë ndarë 25.000 \$ dhe një mirënjohje, prandaj uroj anëtarët e kuvendit për angazhimin dhe punën e sinqertë,

për transparencën që është treguar në punimet e kuvendit komunal, duke uruar edhe stafin administrativ që ka publikuar me kohë të gjitha vendimet e kuvendit komunal. Pastaj tha se këto mjete të grantit duhet të shfrytëzohen në realizimin e projekteve që janë në shërbim të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- duke uruar për shpërblimin që e ka fituar Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, shtoi se ky shpërblim i fituar është dashtë të orientohet në disa projekte që janë në interes të komunës. Në vazhdim paraqiti detajet e orientimit të këtij shpërblimi në projekte të caktuara.

Veli Karaça, anëtar i Kuvendit- duke uruar për suksesin e arritur të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, njëkohësisht ftoi që edhe në të ardhmen të bëhen punë konstruktive në bashkëpunim të ndërsjelltë dhe me transparencë edhe më të madhe në punën e mëtutjeshme. Pastaj lidhur me projektet që janë propozuar që të realizohen me këtë grant, tha se tri projekte me shuma kaq të vogla, ndoshta nuk arrihet qëllimi për çka jepet ky donacion, prandaj Grupi parlamentar i LDK-së propozon që të rriten shumat dhe të realizohen 1 deri në 2 projekte.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- sqaroi se janë bërë analizat se ku mund të shpenzohen dhe sa mund të shpenzohen bashkarisht me përfaqësuesit e USAID-it, duke hartuar projektet në detaje.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i Kuvendit- Grupi parlamentar i PDK-së e mbështet propozim-vendimin në fjalë ashtu siç ka ardhur në kuvend.

Bahrije Pllana, anëtare e Kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të AAK-së uroi për këtë grant që ka fituar Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, dhe njëkohësisht e mbështeti propozim-vendimin ashtu siç ka ardhur në kuvend.

Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit- në emër të LB-së përgëzoi për këtë grant, dhe i mbështeti projektet që i ka propozuar ekzekutivi i komunës.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim nga fondi i USAID-it/DEMI iniciativa për komuna demokratike dhe efektive për v. 2011, mjetet e fondit në shumë prej 25.000 \$, ose 17.250. €, destinohen për realizim të projekteve të komunës si në vijim:

- *Rregullimi i parkut te banesat e bardha - Rr. "Skenderbeu".....7.000 €*
 - *Rregullimi i parkut të qytetit (ulëset dhe fontana) 6.000 €*
 - *Shporta për hedhurina në rrugët e qytetit 4.250 €*
- GJITHSEJT :..... 17.250 €.**

3. Shqyrtimi i Qarkores Buxhetore 01/12, Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB).

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- paraqiti shqetësimin lidhur me planifikimin nga Qeveria e Kosovës për planifikimin e mjeteve për Komunën e Vushtrrisë, duke shtuar se vetëm nga "të hyrat vetanake" i kanë planifikuar 1.772.000 €, dhe njoftoi se ka reaguar në Ministrinë e Financave edhe me shkrim, duke ia kujtuar Qeverisë së Kosovës se është bërë një diskriminim, pasi që granti qeveritar është zvogëluar, prandaj propozoi që planifikimi për këtë vit të mos jetë më shumë se 1.400.000 €.

Zeqir Hasani, anëtar i Kuvendit- duke iu referuar Qarkores Buxhetore 2011-2014, tha se kjo është një qarkore fillestare, e cila mund të ndryshoj. Pastaj tha se Qarkorja Buxhetore 2011-2014 ka dallime të theksuara nga qarkorja 2010-2013, ku vjen në pah dallimi në zvogëlimin e granteve për shëndetësi dhe investime kapitale, dhe kjo është si pasojë e defekteve në mos harmonizimin e politikave makro-fiskale me FMN-në, si dhe ka ndikuar direkt në projeksionin për rritjen e të hyrave vetanake. Mandej tha Korniza Afatmesme e Shpenzimeve është një dokument buxhetor i cili duhet të qarkullon dhe të analizohet nga akterët e nevojshëm me qëllim të caktimit të

prioriteteve, harmonizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke u bazuar në hapat konkret që janë paraparë në këtë kornizë. Gjithashtu tha se kjo qarkore fillestare tregon se ka një rritje totale të grantit të përgjithshëm për 26 % krahasuar me vitin 2011, kurse granti specifik i arsimit shënon një rritje të lehtë, granti specifik i shëndetësisë tregon një rënie të lehtë në vitet në vijim, ndërsa granti i investimeve kapitale tregon rënie në vitet në vijim, dhe nga kjo nënkuptohet që kemi një sfidë para qeverisë lokale për grumbullimin e të hyrave vetanake dhe për gjetjen e mekanizmave dhe formave për mbledhjen e tyre, pasi që të hyrat vetanake prej vitit në vit po kanë një peshë të madhe në pjesëmarrjen në investimet kapitale, dhe shtoi se sipas kësaj kornize, të hyrat vetanake të komunës të projektuara për t'u mbledhur, marrin pjesë afër 46 % në totalin e investimeve kapitale të planifikuara. Në vazhdim tha se duke u bazuar në këta tregues, qeveria lokale me dikasterët e saj duhet t'i caktoj prioritetet për shpenzimet e mjeteve të alokuara nga grantet qeveritare dhe të caktoj prioritet, duke shtuar se prioritet duhet të jetë arsimi, shëndetësia, punësimi, pasi që është bërë shumë pak lidhur me punësimin në këto vite, dhe infrastruktura.

Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit- duke iu referuar deklaratës së drejtimit strategjik, tha se do të duhej shtruar në mënyrë më profesionale, dhe shtoi se ka gabime drejtshkrimore dhe paqartësi me strukturën e fjalive, me ç'rast qytetari i thjeshtë nuk ka mundësi shpeshherë me kuptuar çfarë është thënë, dhe në shumicën e rasteve të drejtimi strategjik, komuna është marrë me përshkrimin e situatës aktuale, duke mos i dhënë vizion drejtimit strategjik. Pastaj lidhur me paraqitjen e disa subvencioneve në bujqësi, sqaroi se subvencion duhet konsideruar investimet që ngritin bruto produktin e komunës, pra subvencioni duhet t'i jep "infuzion" ekonomisë në lëmitë e caktuara, ku është interesi i përgjithshëm i qytetarëve të komunës, kurse dhënia e 10 litrave naftë për të korrur grurin është një ndihmë emergjente, e jo subvencion. Mandej tha se është shqetësuese, pasi që thuhet se komuna ka biznese të regjistruara, por nuk është paraqitur shuma, kurse komuna e ka shumën e saktë, prandaj kërkoi që të përmirësohet dokumenti në fjalë, duke e paraqitur shumën. Pastaj në faqen 5 thuhet "grande", por duhet thënë "grante". Gjithashtu në faqen 6, duke iu referuar tabelarit (buxhetit komunal), tha se nëse iu referohemi grafikoni në faqen vijuese, nuk përkon grafikoni me shifrat që janë prezantuar këtu, sepse grafikoni në vitin e fundit parasheh rënie, ndërkaq te tabelari ka një rritje. Pastaj te fjalja "mbetet sfidë e udhëheqësve komunal që këtë mungesë të grantit ta kompensojnë me ndihmën e donatorëve të jashtëm", propozoi që të rishtrohet dhe të thuhet: "rritjes së efijencës në menaxhimin e shfrytëzimit të burimeve vetjake lokale". Kurse te parashikimi i të hyrave vetjake komunale, në strategjinë e komunës do të duhej të ishte edhe një burim tjetër i të hyrave dhe të emërtohet "të hyrat nga shërbimet konsulente dhe ekspertizat profesionale". Në fund, duke iu referuar strategjisë zhvillimore nëpër sektorët komunal, tha se është për keqardhje që pjesa dërmuese e drejtorive nuk dinë me përshkruar misionin (duke iu referuar dokumentit në fjalë), përveç Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Besim Jashari, anëtar i Kuvendit- tha se Qarkorja Buxhetore në fjalë është shumë e rëndësishme. Pastaj në këtë dokument thuhet se mbahen dëgjime publike për Qarkoren Buxhetore, dhe shtoi se në tubimin e fundit që është mbajtur pjesëmarrja vazhdon të mbetet simbolike e qytetarëve, prandaj i sugjeroi kryetarit të Komunës dhe autoriteteve komunale që për të qenë këto dëgjime publike më efektive, të organizohen në mënyrë të mirëfilltë, duke propozuar që në këto dëgjime të ftohen edhe profesionistët e fushave për të cilat realizohen dëgjimet publike. Në vazhdim lidhur me çështjen e ndërtimeve, tha se në Drejtorinë e Urbanizmit dhe në Drejtorinë e Kadastrit ka mungesë të kuadrove dhe kapacitetet njerëzore nuk janë në nivel të kënaqshëm, prandaj është mirë që të ftohen në mënyrë të sinqertë kuadrot jashtë institucioneve dhe të merret në konsideratë mendimi i tyre.

Pajazit Pllana, anëtar i Kuvendit- duke iu referuar qarkores në fjalë, ku përfshihet edhe shëndetësia primare, tha se Komuna e Vushtrrisë ka një specifikë, pasi që ka

nivelin primar dhe sekondar, dhe shtoi se pasi që grantet në shëndetësi në nivelin qendror kanë tendencë të rënies, shëndeti i popullatës në të gjithë Kosovën rrezikohet, sepse shoqëria bashkë me buxhet duhet të mendon për shëndetin e popullit të vet. Pastaj tha se emergjencia është prej hallkave të para në shërbimin shëndetësor mjekësor ku varet jeta e njeriut, mirëpo nuk po i kushtohet kujdes. Mandej duke iu referuar Ligjit të Kuvendit të vitit 2006, ku thuhet se “mjek i emergjencës është mjeku, që përveç shkollimit adekuat dhe licencës për punë, ka të kryer edhe stazh të emergjencës të paraparë nga programi i emergjencave mjekësore”, prandaj kësaj duhet t’i referohemi dhe ta respektojmë. Mandej tha se në këtë afat duhet të gjejmë një zgjidhje të përbashkët për tejkalim. Në vazhdim tha se mund të bëhet një fuzionim i nivelit primar dhe sekondar, duke bërë një zgjidhje së bashku, për ta ekzekutuar në interesin e qytetarit, në mënyrë që shëndetësia primare dhe sekondare të jep atë që duhet për qytetarët dhe nevojat e tyre. Gjithashtu tha se është interesant se në vijat buxhetore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për emergjencë nuk ka limit, kurse në anën tjetër limitet janë shumë të mëdha dhe të pakalueshme, prandaj niveli primar që është në kompetencën e Komunës së Vushtrrisë, e që pa shërbime të përbashkëta me spitalin, duhet të gjendet një zgjidhje dhe të bëhet një emergjencë e përbashkët të nivelit, për të tejkaluar edhe mundësitë tona, që qytetari të merr atë që duhet, dhe shtoi se është kërkuar që Spitali i Vushtrrisë ta ndihmoj Mitrovicën, dhe e ka pranuar idenë. Në fund tha se shëndeti i popullit të Kosovës dhe i komunës sonë është i rëndë, pasi që çdo të dytën ditë paraqitet nga një rast që vuan nga tumori, e që kërkon një kosto shumë të lartë të shërimit, por shoqëria nuk ka mundësi t’ia ofroj, prandaj duhet të gjendet një zgjidhje, duke kërkuar që spitali së bashku me QKMF-në dhe DSHMS-në ta bëjnë një draft që të tejkalohej kjo dhe të kërkojmë mundësi që në nivel më të mirë ta organizojnë punën e vet.

Veli Karaça, anëtar i Kuvendit- kërkoj që në Kornizën Buxhetore në fjalë të vazhdohet të punohet në të, pasi që ende ka mundësi që në këtë dokument strategjik, i cili duhet të jetë i bazuar në planet strategjike zhvillimore të komunës dhe në programet aktuale të drejtorive, dhe të punohet ende në mënyrë që drejtoritë me programet e veta të konkurrojnë për fondet që janë të parapara me grantet e Qeverisë së Kosovës dhe të hyrat nga kuvendi komunal, por mënyra qysh i kanë paraqitur ata objektivat dhe prioritetet, nuk kanë merituar të përkrahen as me gjysmën e këtyre mjeteve që janë të parapara. Në vazhdim lidhur me parashikimin e shpenzimeve për Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, duke shtuar se për vitin 2011 janë paraparë mbi dy milionë euro, dhe ky buxhet është paraparë kur kjo drejtori ka qenë edhe për zhvillim ekonomik, kurse vlerësimi për vitin 2012 është mbi dy milionë euro, prandaj pyeti drejtorin e Drejtorisë së Financave se a nënkuptohet këtu zhvillimi ekonomik, apo vetëm bujqësia? Mandej paraqiti shqetësimin e tij lidhur me mjetet e ndara për kulturë, rini dhe sport, duke shtuar se këto mjete janë të pamjaftueshme, dhe kërkoj që rinisë, kulturës dhe sportit t’i ipet prioritet për vitet e ardhshme, duke investuar më shumë në rininë tonë. Në fund lidhur me kreun e V-të që ka të bëjë strategjinë zhvillimore për sektorët komunal, kërkoj që edhe një herë drejtorët e drejtorive t’i definojnë misionet, t’i përcaktojnë objektivat e qarta, t’i identifikojnë mundësitë dhe kërcënimet, dhe t’i planifikojnë aktivitetet për të ardhmen.

Muharrem Shabani, anëtar i Kuvendit- tha se dokumenti në fjalë është i një rëndësie të veçantë, por konsideroi se duhet shikuar në mënyrë reale dhe objektive, duke mos aprovuar buxhet të dëshirave, por buxhet real. Pastaj tha se jo vetëm Komuna e Vushtrrisë, por edhe Kosova është e hendikepuar, dhe në tërësi buxheti i shtetit, sepse kemi një çrregullim të buxhetit, pasi që një shtet i cili largohet nga mekanizmat financiar ndërkombëtar dhe nuk e ka përkrahjen e tyre, e ka vështirë të realizoj edhe objektivat e veta, mandej kërkoj që në rastin konkret t’iu përmbahemi afateve të parapara për miratimin e buxhetit. Gjithashtu tha se akoma nuk e din se sa

kemi të hyra vetanake të painkasuara nga vitet paraprake, kurse Ministria e Financave i ka këto të dhëna sa janë mjetet sipas viteve që kanë mbetur. Në vazhdim shtoi se përderisa nuk e dimë numrin e bizneseve në komunën tonë, sa biznese janë aktive, sa janë pasive, nuk dihen adresat, atëherë nuk mund të dihet realisht as planifikimi dhe të hyrat vetanake në komunën tonë, duke shtuar se sipas indikacioneve ka biznese të shumta që ende funksionojnë pa leje pune. Kurse tha se prioritet i prioriteteve për komunën tonë është zhvillimi i bujqësisë. Në fund tha se Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë ka nevojë të informohet rreth proceseve të integritit, se sa qytetarë tonë do të kthehen nga jashtë, a kanë strehim, a kanë punësim, a kanë burime të jetës për të ardhmen.

Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit- duke iu referuar dokumentit në fjalë, në faqe nr. 4 te mjekësia sekondare, tha se spitali ynë për çdo ditë po iu del në ndihmë qytetarëve edhe të komunave tjera me operacione nga më të komplikuarat, prandaj Qeveria e Kosovës është dashtë ta ketë parasysh këtë fakt, duke e ditur edhe faktin se spitali disponon edhe aparatura që janë shumë moderne, falë ndihmës së Emirateve të Bashkuara Arabe, mirëpo këto aparatura dhe ky spital kanë nevojë për grante, duke shtuar se Drejtoria e Shëndetësisë është mirë që ta përgatit një strategji në këtë drejtim dhe t'i drejtohet Qeverisë së Kosovës që të kërkoj grante në këtë drejtim.

Isuf Jashari, anëtar i Kuvendit- tha se me datën 23.05.2011 kemi marrë Qarkoren e parë Buxhetore 2012/01, dhe shtoi se në Qarkoren Buxhetore janë afatet, janë limitet buxhetore qoftë prej grnatit, qoftë prej të hyrave, e të cilave afate duhet t'i përmbahemi dhe në afatin e duhur kohor. Pastaj njoftoi se lidhur me Qarkoren Buxhetore në fjalë është mbajtur edhe një dëgjim buxhetor me qytetarët e Komunës së Vushtrrisë. Në vazhdim tha se është brengosëse çështja e kufijve buxhetor, pasi që në qarkoren 01 janë kufijt fillestar, por me marrjen e qarkores 02/2012 do të ketë ndryshime dhe lëvizje të kufijve buxhetor. Kurse sa i përket Kornizës Afatmesme Buxhetore, tha se nuk ka një formë standarde të Kornizave Afatmesme Buxhetore nëpër komuna, por secila komunë e përpilon kornizën në bashkëpunim me drejtorët e drejtorive. Në vazhdim duke iu përgjigjur pyetjeve dhe shqetësimeve të anëtarëve të Kuvendit, tha se te "projeksioni i të hyrave" grafikonat janë në rregull, pasi që forma tabelare që është paraqitur, nuk është plotësisht e printuar, kurse te grafikoni nr. 3 është disproporcioni që tregon nivelin e ngritjes së të hyrave. Mandej tha se në kornizë paraqiten të dhënat vetëm në vija të trasha. Kurse duke iu referuar pyetjes lidhur me buxhetin e Drejtorisë për Bujqësi, u përgjigj se shpërndarja e buxhetit për vitin 2012 është bërë në bazë të këtyre kufijve fillestar, pasi që këta nuk janë kufij final, kurse është politikë fiskale e komunës që ta përcakton se në cilën drejtori do të mbesin investimet kapitale, duke arsyetoi se emërtimi Drejtori për Bujqësi, Pyltari dhe Zhvillim Rural është i tillë në formën standarde tabelare të Qeverisë së Kosovës. Gjithashtu lidhur me buxhetin për kulturë, rini dhe sport, tha se kërkesat që i kanë drejtorët e drejtorive, as kërkesat minimale nuk mund të plotësohen, pasi që buxheti shpërndahet varësisht prej kërkesave që kanë prioritet më të madh. Në fund duke iu referuar çështjes së bizneseve, tha se informatën që e marrin prej MTI-së figuron emri i biznesit, adresa dhe pronari, duke shtuar se çdo ditë do të ketë biznese pa leje, biznese të reja, pasi që zhvillimi ekonomik në privatizim e lejon që çdo ditë të regjistrohen biznese të reja, dhe një numër i madh i bizneseve hapet për qëllime të ndryshme komerciale.

Muharrem Shabani, anëtar i Kuvendit- tha se është përgjegjësi pasi që sa herë kemi kërkuar, por nuk kemi marrë shënime sa kemi obligime të painkasuara sipas viteve, duke shtuar se janë ato të tatimit në pronë prej fillimit se kush sa ka mbetë, janë ato të firmave të cilat i kanë përmush, prandaj pa i pasur këto shënime dhe këto elemente të të hyrave, është vështirë të bëjmë për vitet në vijim.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- tha se pushteti lokal është jashtë ndikimit të mundësive që të ndikojmë për të qenë apo mos me qenë në FMN, duke shtuar se obligimet që i ka marrë Qeveria e Kosovës për shtim të të hyrave brenda një viti prej

18 % janë shumë ambicioze. Kurse sa i përket të hyrave vetanake, dhe në veçanti të tatimit në pronë, tha se vazhdimisht janë duke u përmirësuar të hyrat në këtë shtyllë buxhetore, dhe më të mirat deri më tani janë në këtë vit, dhe tha se është për transparencë, duke mbështetur edhe publikimin e listës së borxhlinjëve. Kurse duke iu referuar pyetjes lidhur me procesin e integriteteve, tha se jemi plotësisht në rrjedhë, duke njoftuar se deri tani nuk ka shumë të rikthyer, por janë duke u zhvilluar procedurat për ndihmë për ata që janë kthyer, mirëpo pritet që në të ardhmen të rritet numri i të rikthyerëve. Gjithashtu njoftoi se e ka formuar Grupin i cili do ta hartonte planin e veprimtimit për të gjitha obligimet që na përkasin ndaj të rikthyerëve, duke përfshirë aspektin social, shëndetësor dhe arsimor. Në fund lidhur me kufijt buxhetor, tha se me sugjerimin e drejtorëve të qeverisë komunale është bërë lëvizja buxhetore, kryesisht e projekteve për asfaltime, duke i caktuar në Drejtorinë për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim, pasi që edhe pretendimi i tij është që në kuadër të kësaj drejtorie të formohet një Zyrë e Planifikimit, e cila pastaj do të menaxhonte këto projekte, mirëpo pasi që është menduar përsëri lidhur me çështjen në fjalë, pritet që kjo zyrë të hapet në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm.

Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit- tha se kjo formë e përgatitjes së kësaj strategjie është për keqardhje, duke u ndalur vetëm tek Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe shtoi se të misioni, drejtori i përkrahur aktivitetet operacionale, që nuk përkohet asgjë as me misionin dhe as me synimet. Gjithashtu, të vlerësimi i mundësive dhe kërcënimeve gjatë periudhës buxhetore, flet vetëm për një pjesë të kërcënimeve, kurse për pjesën kryesore të kërcënimeve nuk flet, ndërkaq për mundësitë asnjë drejtor nuk ka folur fare. Mandej të objektivi i drejtorisë është thënë se është plotësimi me kuadro profesionale, mirëpo objektivi i drejtorisë duhet të jetë sigurimi i burimeve të qëndrueshme financiare, menaxhim eficient i buxhetit dhe pasqyra të besueshme financiare. Në fund duke iu referuar misioneve të të gjitha drejtorive, përveç Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, tha se të gjitha misionet e drejtorive tjera janë të shtruara në mënyrë qesharake.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim aprovohet Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Vushtrrisë për periudhën 2012-2014.

4. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për shërbimin me “merimangë” për territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Veli Karaça, anëtar i Kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, nenit 1, pyeti se a duhet të zhvendosen vetëm automjetet e parkuara apo edhe të ndaluarat, pasi që Vushtrria është qytet i vogël, dhe mund të ndalohej për disa minuta, derisa policia t’ia tërheq vërejtjen apo edhe t’ia shqipton ndonjë dënim, por jo edhe t’i zhvendoset vetura. Kurse lidhur me nenin 2.4 dhe 2.5, tha se këto dy paragrafe janë përafërsisht të ngjashme, prandaj nuk ka nevojë të mbesin të dyjat në rregullore, duke iu referuar paragrafit 2.4 shtoi se Kuvendi i Komunës nuk është organ për të përcaktuar lokacionin apo vendin brenda autoparkut, dhe propozoi që të hiqet paragrafi në fjalë, pasi që edhe është i paqartë, dhe paragrafi 2.5 e mbulon këtë. Te neni 3.1, propozoi që të hiqet fjalia “...të inspektorit komunal të komunikacionit...”, duke arsyetuar se nuk mund të bëhet bartja e automjetit me urdhër të inspektorit komunal, pa praninë e policisë. Te neni 9.6, tha se për shumën prej 5 € askush nuk e ruan një automjet të bllokuar 24 orë, prandaj propozoi shumën prej 20 €. Te neni 9.7, tha se të gjitha pagesat duhet të bëhen sipas kontratës, pasi që pronari i automjetit, i cili e ka parkuar apo ndaluar automjetin, ia paguan gjobën policisë për parkim ose ndalim të paligjshëm, ndërsa operatorit për zhvendosje apo bartje të automjetit, dhe nga pjesa për bartje një përqindje i takon komunës, prandaj të gjitha këto pagesa nuk mund të bëhen përmes bankës, si të hyra të komunës, pasi që nuk janë të gjitha

të hyra të komunës. Te neni 12.4, tha se periudha prej 5 vitesh është shumë, dhe drejtorja nuk ka të drejtë që pas 5 viteve të shkon të kontrollojë dokumentacionin e një operatori me të cilin e ka ndërprerë kontratën.

Hajrulla Muli, anëtar i Kuvendit- duke iu referuar nenit 9.1, tha se shuma prej 30 € është e lartë, dhe propozoi shumën prej 20 €, duke e arsyetuar se edhe policisë duhet t'ia paguan gjobën prej 25-35 €. Duke iu referuar nenit 6.6, tha se nuk është cekur se sa duhet të jetë numri i punëtorëve të kompanisë.

Muharrem Shabani, anëtar i Kuvendit- kërkoi që t'iu shpërndahet të gjithë anëtarëve të Kuvendit nga një kopje e statutit të ri, dhe sipas atij statuti, hyrja në fuqi e të gjitha vendimeve dhe rregulloreve që nxjerr kuvendi është 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë, duke kërkuar që neni 16 të hartohet në përputhje me statutin e ri.

Sami Istrefi, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike- njoftoi se e ka marrë një Informatë me shkrim nga kompania “Çlirimi” që vepron për bartje të automjeteve dhe nga vitet 2001-2011 janë 38 automjete të braktisura, prandaj me këtë rregullore sado pak do ta zgjidhim këtë problematikë shumë të madhe. Kurse lidhur me nenin 1, tha se është e përcaktuar në bazë të Udhëzimit Administrativ 02/2009, pra ku kemi të bëjmë me automjetet e ndaluara dhe të parkuara në hapësirat publike, në të cilat nuk është e lejuar as ndalimi dhe as parkimi. Te neni 2.4, tha se komuna sipas Udhëzimit Administrativ është e obliguar që ta cakton autoparkun ose lokacionin për vendosje të automjeteve që merren nga kompania në fjalë, duke shtuar se është konstatuar se komuna ka pak pronë publike, prandaj është shtuar neni 2.5, se nëse komuna nuk do të ketë mundësi ta zgjidh problemin e parkingut ose autoparkut, atëherë kompania e cila është përfutuese e këtij tenderi është e obliguar ta ketë edhe autoparkun për vendosjen e automjeteve. Në vazhdim arsyetoi çështjet tjera të ngritura nga anëtarët e Kuvendit lidhur me draft-rregulloren në fjalë.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- duke iu referuar nenit 2.4, propozoi që fjala “autopark” të fshihet.

Veli Karaça, anëtar i Kuvendit- tha se asnjëherë nuk ka parë autobus, kamionë me rimorkio që zhvendosen me “merimangë”, por ato bllokohen aty ku janë të parkuara ose të ndaluara në mënyrë të paligjshme, prandaj aty duhet të ruhen. Pastaj te neni 12.5, propozoi që të hiqet fjalia “sipas kërkesës së drejtorisë...”.

Besim Jashari, anëtar i Kuvendit- tha se janë disa automjete që një kohë të gjatë janë të braktisura, dhe propozoi që të identifikohet pronari dhe t'i dërgohet fletëparaqitje, duke i paralajmëruar që brenda një kohe të caktuar nëse nuk i largojnë ato vetura të braktisura, pason dënimi. Gjithashtu edhe për automjetet e parkuara në vende të ndaluara, të cilët po i tërheqin me “merimangë”, propozoi që t'iu merren targat, t'i shqiptohet dënimi, dhe pastaj askush nuk do ta parkon në vendin e ndaluar, mirëpo organet që e zbatojnë ligjin duhet me qenë të vendosura në zbatimin e ligjit, dhe kërkoi që të fuqizohet zbatimi i ligjit.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i Kuvendit- te neni 13 propozoi të futet paragrafi 13.4 si paragraf i ri, me këtë përmbajtje: “Automjetet e braktisura (me motor) që gjenden në vendet publike, kompania do t'i dërgon në autopark, dhe nëse brenda 6 muajve pronari nuk e tërheqë automjetin e vet, i njëjti do të procedohet në ankand publik që të shitet”.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- lidhur me ndryshimet dhe plotësimet e Draft-rregullores në fjalë propozoi me sa vijon: neni 2.4 të riformulohet, duke e hequr fjalën “autopark”. Te neni 3.1 të hiqet fjalia “të inspektorit komunal të komunikacionit”; te neni 9.6 të rritet shuma në 20 €. Te neni 9.7 të thuhet “Të gjitha pagesat nga paragrafi paraprak do të bëhen sipas kontratës, përmes bankës”. Te neni 12.5 të hiqet fjalia “sipas kërkesës së drejtorisë”. Te neni 13 të shtohet paragrafi 13.4, si paragraf i ri me tekstin e lartpërmendur.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohet Rregullorja në fjalë, duke inkorporuar vërejtjet dhe propozimet e paraqitura nga anëtarët e Kuvendit, të përmbledhura nga kryesuesi i Kuvendit.

5. Shqyrtimi i propozim-vendimeve për ridestininim të mjeteve buxhetore të komunës nga:

- a. Projekti “Rregullimi i kanalizimeve” në shumën prej 25.000 €;**
- b. Projektet kapitale 2011 të komunës në shumën prej 128.480 €;**
- c. Projektet kapitale në rr. “Dëshmorët e Kombit” në shumën prej 100.000 €;**
- ç. Projektet kapitale “Blegtori, pemëtari dhe perimkulturë” në shumën prej 7.000 €.**

Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit- lidhur me ridestininimin e mjeteve që janë paraparë nga sektori i bujqësisë, tha se ato që janë paraparë për blegtori, pemëtari dhe perimkulturë është mirë që të mos ridestinohen dikund tjetër, pasi që komuna jonë është vend agraro-bujqësor, prandaj është mirë që të mbesin në vendin e veçantë ku kanë qenë të destinuara, pasi që ka nevojë që t’iu ndihmohet bujqëve, duke shtuar se është kundër ridestininimit të shumës prej 7.000 €.

Nasuf Aliu, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim- tha se pasi që në këtë vit nuk do të ketë rishikim të buxhetit, këto mjete janë parë të arsyeshme që të ridestinohen në këto projekte, duke shtuar se vonesa e alokimit të buxhetit ka ndikuar edhe në stagnimin e projekteve të komunës, por edhe në aspektin ekonomik, nëse shikohet ky ridestininim i mjeteve në buxhetin për rregullim të “bankinave”, e ka një efektshmëri shumë më të madhe, pasi që në vitin e kaluar fermerët tanë përgjatë lumit “Sitnica” kanë pasur dëme mbi 350.000 €.

Veli Karaça, anëtar i Kuvendit- tha se Grupi parlamentar i LDK-së pajtohet me këto bashkëfinancime, mirëpo kërkoi nga Drejtoria për Shërbime Publike që mjetet prej 25.000 € që janë të ridestinuara për furnizim me gypa të kanalizimit, kuvendi të informohet se kujt iu kanë ndarë këta gypa.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- duke iu referuar pyetjes së anëtarit të Kuvendit V. Karaçës, u përgjigj se kryesisht furnizimi me gypa bëhet për ato projekte ku bëhet ndërtim i asfalteve, pasi që ndërtimi i asfaltit duhet patjetër ta ketë infrastrukturën përkatëse të kanalizimit dhe rrjetit të ujësjellësit.

Në fund të diskutimit lidhur me këto nënpika të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim mjetet buxhetore të komunës nga projekti “Rregullimi i kanalizimeve” në shumë prej 25.000 € ridestinohen: 20.000 € në projektin “Furnizimi me gypa të kanalizimit” dhe 5.000 € në projektin “Rregullimi i rrugëve të rendit të IV-të”.

Me këtë vendim mjetet e lira buxhetore të mbetura nga realizimi i projekteve kapitalet të vitit 2011 të komunës në shumë prej 128.480 € ridestinohen në projektin “Ndërtimi i rrugës Ashlan-lagjja Bahtiri-fabrika e ujit-Akrashticë”.

Me këtë vendim mjetet buxhetore të komunës nga projekti nr.16 në listën e projekteve kapitale të vitit 2011 rr. “Dëshmorët e Kombit” në shumë prej 100.000 € ridestinohen në projektin “Ndërtimi i rrugës Strofc-Bequq-Mihaliq”.

Me këtë vendim mjetet buxhetore të komunës nga projekti nr.14 në listën e projekteve kapitale të vitit 2011 “Blegtori, Pemëtari dhe Perimkulturë” në shumë prej 7.000 €, ridestinohen në projektin nr.15 “Rregullimi i bankinave të Lumit Sitnica” në territorin e komunës së Vushtrrisë.

6. Shqyrtimi i petitionit nga banorët e fshatit Begaj të Komunës së Vushtrrisë.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- duke iu referuar petitionit në fjalë, tha se në KPF është diskutuar dhe kemi dalë me një propozim që ekzekutivi t'i caktoj ekspertët nga departamenti i vet dhe të vjen me konstatim të gjendjes, duke e sjellur një raport në Kuvend, pastaj Kuvendi vendos se çka do të bëhet.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- tha se ajo tokë nuk është e përshtatshme sidomos gjatë stinës së verës për varrosje, duke paraqitur një ide për të hapur një pus dhe gjatë verës të mirëmbahen varrezat, duke i vaditur, dhe njëkohësisht e mbështeti propozimin për formimin e komisionit për çështjen në fjalë.

Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të LDK-së kërkoi që Kryetari i Komunës në bazë të kompetencave të tij ta formon komisionin prej ekspertëve, për të dalur në vendin e ngjarjes, dhe për të hartuar një dokument, i cili me rekomandime të vjen në Kuvend, në mënyrë që të zgjidhet ky problem, dhe shqetësim i qytetarëve.

Veli Karaça, anëtar i Kuvendit- tha se nuk ka dyshim që kundërmojnë erëra të rënda nga varrezat. Mandej tha se shqetësimi i banorëve të fshatit Begaj është i vjetër me vite të tëra, duke shtuar se që në fillim nuk është përmbushur projekti që ka qenë për ndërtimin e varrezave, pasi që me projekt ka qenë ndërtimi i një pusi për ujitjen e varrezave. Pastaj propozoi që të transportohet një sasi e dheut dhe të mbulohen varrezat deri në një nivel, pasi që përbërja e dheut aktual të varrezave nuk siguron dhë të imtë.

Besim Jashari, anëtar i Kuvendit- tha se shqetësimi i qytetarëve është mjaft serioz, dhe shtoi se në afërsi të varrezave ka parë qen të ngordhur. Pastaj e mbështeti propozimin për formimin e një komisioni, duke kërkuar përcaktim të një afati konkret për ndërmarrjen e masave.

Xhylsime Feka, anëtare e Kuvendit- tha se është shumë e nevojshme që të përcaktohet një afat i shkurtë, duke u formuar komisioni nga Kryetari i Komunës, dhe të konstatohet gjendja aktuale dhe reale në varrezat në fjalë, dhe komuna të mendoj për një lokalitet tjetër, larg ndonjë vendbanimi, në mënyrë që qytetarët mos të vuajnë nga vendimet e gabuara, ashtu siç janë duke vuajtur tash banorët e fshatit Begaj.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim autorizohet Kryetari i Komunës që të formon një komision profesional për të konstatuar gjendjen faktike në varrezat e qytetit në fshatin Begaj, dhe i njëjti komision duhet t'i raporton Kuvendit të Komunës në seancën e muajit korrik.

7. Shqyrtimi i propozimit për anulim të vendimit të Kuvendit të Komunës.

Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit- tha se për këtë pikë të rendit të ditës është dashtë që anëtarët e Kuvendit ta kenë një raport se sa ka inkasuar komuna prej kohës kur iu ka dhënë në shfrytëzim këtij pronari, ose nuk ka inkasuar fare, dhe pyeti kush mban përgjegjësi pse ka dështuar, dhe shtoi se kur janë dhënë këto prona në shfrytëzim, Grupi parlamentar i LDK-së nuk ka marrë pjesë në diskutim, dhe as në votim, për shkak se nuk jemi pajtuar me formën se si janë dhënë, duke njoftuar se edhe sot Grupi parlamentar i LDK-së nuk do të debatohet për këtë çështje dhe nuk do ta përkrah anulimin e vendimit.

Zeqir Hasani, anëtar i Kuvendit- tha se pasi që këto parcela janë dhënë duke mos bërë asnjë analizë të planeve të bizneseve, kurse tani dorëheqja nga ky investim thuhet se është për shkaqe financiare, por atëherë në planin e biznesit ka paraqitur investime dhe punësime, mirëpo nga kjo kuptohet se ka qenë e përgatitur, dhe jo transparente, e panjoftuar për komunitetin e biznesit, prandaj ka ardhur deri te

dështimi, duke propozuar që në të ardhmen nëse qiten këto parcela në konkurs, fituesi i asaj parcele të ketë një garancion në vlerë minimale prej 10.000 €, e nëse fituesi tërhiqet, mjetet i merr komuna.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- tha se drejtorja përkatëse dhe Zyra Ligjore duhet të angazhohen për të kuptuar nëse fituesi i parcelës që ka kërkuar të tërhiqet, i ka mbetur borxh komunës, t'i kërkohej kthimi i borxhit, e nëse refuzon kthimin e borxhit, të kërkohej kthimi i borxhit përmes gjyqit.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Anulohet vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr.218/10, dt.30.09.2010, për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim, të pronës së paluajtshme të komunës, z. Kreshnik Bashollit pronar i Sh. P. K. "Betimi" me seli në Vushtrri, pjesa e parceles kadastrale 8-412, fletë poseduese nr. 198 (12/287), në sipërfaqe prej 70 ari, ZK Stanoc i Poshtëm, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

8. Shqyrtimi i propozimeve të ZLK-së për emërimin e anëtarëve shtesë të Komitetit për Komunitete.

Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë Vendim emërohen anëtarët shtesë të Komitetit për Komunitete, siç vijon:

- 1. Bratislav Kostiq;*
- 2. Milan Kostiq.*

9. Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë financiare në vlerë prej 5.000 € veteranëve të luftës së UÇK-së për shënimin e 28 qershorit, ditës së themelimit të Brigadës-Zona Operative e Shalës.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- paraqiti sqarime shtesë lidhur me kërkesën në fjalë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 20 vota "për", 1 "kundër", të tjerët "abstenim", vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim lejohen mjete financiare nga fondi për subvencione në llogari të Organizatës së Veteranëve të luftës së UÇK-së, dega në Vushtrri, në shumën prej 5.000 €, për shënimin e ditës së formimit të Brigadës së UÇK-së – Zona Operative e Shalës.

Obligohet Drejtoria për Shëndetsi dhe Përkujdesje Sociale që të lidhë marrëveshje me përfituesin e këtyre mjeteve, i cili do të hartoj raport për mjetet e shpenzuara në shumën e cekur si në nenin paraparak.

10. Shqyrtimi i Informatës rreth furnizimit me ujë të pijshëm për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë.

Sami Istrefi, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike- informoi se javën e kaluar, së bashku me menaxherin e njësisë së ujësjellësit, Drejtorinë e Inspektionit dhe policinë e Kosovës kanë shkuar në fabrikë të ujit, dhe shtoi se nga fabrika e ujit në Shipol 510 litra janë për rezervuarin e ujit të pijshëm, i cili duhet të vjen në Vushtrri, dhe tha se gypi qendror që vjen nga fabrika drejt në Vushtrri është i dëmtuar duke u kyqur ilegalisht mbi 7 fshatra të Komunës së Mitrovicës. Poashtu tha se në bazë të një informate një person i caktuar në fashtin Pirçë ka dëmtuar gypin, pasi që ka hapur një bazen të peshqve, dhe nga aty furnizohet ilegalisht me ujë. Në vazhdim tha se uji që i takon Komunës së Vushtrrisë, nuk e marrim as 70 litra, prandaj ka kërkuar nga menaxhmenti i ujësjellësit që kjo gjendje të evitohet me urgjencë, duke e ndaluar keqpërdorimin e ujit të pijshëm. Pastaj tha se komuna i ka ndërmarrë të gjithë hapat e mundshëm për ta zgjidhur problemin në fjalë. Mandej njoftoi se së bashku me

menaxhmentin në Vushtrri është bërë një ndarje e ujit ndryshe, me qëllim që qytetarët që banojnë në kate të larta të banesave të furnizohen me ujë.

Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit- lidhur me mungesën e madhe dhe të vazhdueshme të ujit të pijshëm, tha se duhet menduar që gjatë muajve qershor, korrik dhe gusht, komuna, gjegjësisht Drejtoria për Shërbime Publike të përgatitet që përmes “cisternave” të furnizon qytetarët me ujë nëpër pika të caktuara të qytetit.

Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit- tha se Komuna e Vushtrrisë i ka dy anëtarë në bordin e kompanisë regjionale të ujësjellësit në Mitrovicë, kurse njëri është edhe anëtar i Kuvendit, prandaj do të ishte mirë që prej tij të informohemi, pasi që ai është pjesë e vendimmarrjes.

Besim Jashari, anëtar i Kuvendit- tha se e drejta e furnizimit me ujë është e drejtë elementare njerëzore, prandaj mungesa e ujit të pijshëm është mungesë e një të drejte elementare për jetesë, dhe më së shumti mungesën e ujit të pijshëm e ndiejnë banorët e banesave publike në kate të larta. Pastaj kërkoi nga Kryetari i Komunës dhe drejtori i DSHP-së që së bashku me dy anëtarët e bordit nga Komuna e Vushtrrisë që janë në ujësjellësin regjional të bisedojnë edhe me Kryetarin e Komunës së Mitrovicës. Mandej tha se përveç që mungon uji i pijshëm, edhe ata ujë të pijshëm që e kanë në pusët e veta, nuk është i pastër në aspektin shëndetësor, dhe shtoi se disa analiza që janë bërë nga Enti Higjienik del se uji i pusëve në Vushtrri gati në të gjitha pusët është i papastër, prandaj komuna do të duhej që krahas sigurimit të furnizimit me ujë, të siguronte furnizimin me ujë të pijshëm të shëndetshëm, dhe tha se uji i papastër është shkaktar i shumë sëmundjeve infektive, prandaj sigurimi i ujit të pijshëm të pastër është një e drejtë dhe obligim që duhet siguruar autoritetet komunale. Gjithashtu tha se është folur shumë për keqpërdorim dhe për vjedhje të ujit të pijshëm, por nuk kemi dëgjuar për shqiptim të masave ndëshkuese për keqpërdoruesit e ujit.

Xhylsime Feka, anëtare e Kuvendit- duke iu referuar informatës së paraqitur nga drejtori i DSHP-së, pyeti se pasi që është identifikuar keqpërdorimi i ujit të pijshëm, a janë ndërmarrë masa ndaj keqpërdoruesit të ujit të pijshëm. Pastaj kërkoi nga Kryetari i Komunës dhe Drejtori i DSHP-së që ta ftojë menaxherin e ujësjellësit rajonal për të na informuar se çfarë është ndërmarrë për të ndërprerë keqpërdorimet e ujit që po ndodhin.

Veli Karaça, anëtar i Kuvendit- lidhur me problemin e mungesës së ujit, tha se nuk mund të pritët deri sa të ndërtohet fabrika e ujit, pasi që edhe kur të ndërtohet fabrika, nuk ka me i zgjedh problemin. Pastaj tha se mbetet obligim i të gjithë përgjegjësve që të ndërmarrin masa, por edhe të zbatojnë Urdhëresën. Gjithashtu shtoi se në asnjë familje nuk po kursehet uji ashtu siç duhet, duke shtuar se edhe kur të ndërtohet fabrika e re e ujit nuk do të ketë ujë të mjaftueshëm për të vaditur kopshtet dhe arat, prandaj opinioni duhet të vetëdijësohet se uji i pijshëm është një resurs shumë kritik, dhe çdo ditë e më tepër ka mungesë të tij, prandaj duhet të fillohet për t’u zbatuar Urdhëresa e nxjerrur nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë. Në fund tha se problemin e furnizimit me ujë të pijshëm për Komunën e Vushtrrisë mund ta zgjidhin kryetarët e tri komunave në marrëveshje me fabrikën e ujit.

Pajazit Pllana, anëtar i Kuvendit- tha se uji është burim i jetës, dhe komuna e ka për obligim ta përcjellë situatën epidemiologjike në periudhën verore, dhe mungesa e ujit ka me shkaktuar telashe të reja, kurse mundësia e komunës dhe e menaxhmentit tonë është kjo, mundësi tjera nuk ka, mirëpo operative le të jenë:

1. Analizat nga Instituti Kombëtar të Shëndetit Publik të ujit të jenë të rregullta;
2. Situata epidemiologjike në komunë të përcillet në interval të caktuar kohor, pasi që janë paraqitur shenjat e para të bark qitjeve të fëmijët, si rezultat i mungesës së ujit dhe kushteve elementare të jetës;
3. Komuna e Vushtrrisë nuk mund të sigurojë ujë në këtë kohë, por duhet të gjej një zgjidhje, duke mbetur nën përgjegjësinë e atyre që janë kompetent, dhe të bëjnë një zbutje të situatës, duke propozuar që “Tërstenka” e cila paraqet një vend

kontaminimi për qytetarët, në mungesë të vegjetacionit, të eliminohen ato mbeturina, dhe të mos jetë burim i vazhdueshëm i infeksionit për banorë dhe për qytetin e Vushtrrisë. Në fund kërkoi që edhe keqpërdoruesit e ujit të pijshëm nga Komuna e Vushtrrisë të dënohen.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- tha se problemi i furnizimit me ujë të pijshëm për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë, është problem i vjetër, prandaj nuk është e lehtë që të zgjidhet problemi në fjalë. Pastaj tha se janë bërë përpjekje maksimale nga autoritetet komunale që të përmirësohet furnizimi me ujë të pijshëm, por nuk ka pasur rezultate të kënaqshme, duke shtuar se është bërë një përmirësim pasi që është bërë ndërrimi i drejtorëve në kompaninë regjionale të ujësjellësit, duke u përmirësuar gjendja ekzistuese për 40 %. Në vazhdim premtoi që së bashku me qeverinë komunale do të vazhdon të angazhohet duke realizuar takime me kryetarët e komunës së Mitrovicës dhe të Skenderajt, pastaj me udhëheqjen e kompanisë së ujësjellësit në Mitrovicë, dhe do ta angazhon inspektionin për të shqiptuar dënime për keqpërdoruesit e ujit të pijshëm. Mandej tha se një angazhim të veçantë duhet bërë për furnizim të banorëve të kateve të larta të banesave publike, dhe disa lagje të qytetit të furnizohen me ujë përmes “cisternave”.

Xhemajl Pllana, anëtar i Kuvendit- tha se zgjidhja e këtij problemi është shumë e lehtë, pasi që dihen keqpërdoruesit në çdo fshat, dihet kush i ka qel ilegalisht gypat shumë të gjerë dhe që 10 vite po torturohet ky popull, duke shtuar se ligjet dhe rregulloret janë, por organet kompetente nuk janë të vendosura për t’u ballafaquar me problemet dhe vështirësitë, duke e quajtur këtë krim ndaj popullatës.

Sami Istrefi, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike- duke iu referuar keqpërdoruesve të ujit të pijshëm, tha se në bazë të vendimit të kuvendit të komunës jemi duke punuar bashkarisht me policinë e Kosovës dhe me inspektionin në mënyrë që të parandalojmë të gjithë keqpërdoruesit e ujit. Kurse, lidhur me kërkesën që të përdoren “cisternat”, tha se janë në konsultime me Shkollën e Policisë në Vushtrri, me zjarrfikësit, me qëllim që të gjejmë një “cisternë” e cila do të furnizonte me ujë banorët e kateve të larta të banesave. Mandej duke iu referuar shqetësimit të ngritur lidhur me cilësinë e ujit, tha se fabrika nuk guxon ta bën një lëshim profesional që të furnizon qytetarët me ujë, pa u bërë analizat nga Enti Higjienik. Mandej njoftoi se e kanë pastruar lumin “Tërstena”, dhe një pjesë ka ujë, kurse një pjesë tjetër nuk ka ujë. Kurse lidhur me shqetësimin për kyçjet ilegale që janë bërë në gypin kryesor që vjen nga fabrika në Vushtrri, tha se fatkeqësisht shumica prej tyre janë legalizuar nga organet gjegjëse të kompanisë.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- duke shprehur shqetësimin e tij lidhur me mungesën e furnizimit të mjaftueshëm me ujë të pijshëm, tha se është një defekt që komuna nuk e menaxhon ujësjellësin, prandaj problemi qëndron në atë se uji po ndalet akoma pa arritur në Vushtrri, dhe propozoi që të jetë kërkesë e Kuvendit Komunal të Vushtrrisë drejtuar Bordit regjional të ujësjellësit që Vushtrria të furnizohet më mirë dhe ata t’i gjejnë keqpërdoruesit dhe të ngrisin padi penale ndaj tyre.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- propozoi që të del një konkluzion përmes së cilit bëhet e ditur se anëtarët e Kuvendit Komunal të Vushtrrisë shprehën shqetësimin e tyre në lidhje me mungesën e madhe të furnizimit me ujë të pijshëm për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë, në veçanti për muajt e verës, dhe propozoi që t’iu drejtohem kompanisë së ujësjellësit në Mitrovicë, për të bërë maksimumin e mundshëm për ta evituar gjendjen aktuale.

Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit- pasi që paraqiti shqetësimin e tij për mungesën e furnizimit me ujë, dhe pasi që është duke u ndërtuar fabrika e ujit, propozoi që të futet në plan edhe mundësia që të kemi disa burime për ujë teknik (industrial), duke kërkuar që uji i fabrikuar të mos përdoret aty ku nuk duhet.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- duke iu referuar kërkesës për ujë teknik, tha se nuk është e lehtë që të ketë ujë teknik për tërë qytetin, pasi që kërkohet një sistem i ri dhe gypa të veçantë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

I rekomandohet Bordit regional të ujësjellësit që situata e ujit të pijshëm në Komunën e Vushtrrisë është alarmante, dhe ata t'i përdorin mekanizmat e vet, në mënyrë që të përmirësohet furnizimi me ujë të pijshëm në Komunën e Vushtrrisë.

11. Shqyrtimi i Informatës rreth përgatitjeve të Komunës së Vushtrrisë për korrje-shirjet.

Nasuf Aliu, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim- njoftoi se gjatë kësaj periudhe e kanë në kompetencë hartimin e listës së autokombanjerëve të cilët do të zhvillojnë korrje-shirjet në territorin e Komunës së Vushtrrisë, gjithashtu duhet plotësuar dhe dorëzuar formularin standard që vjen nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, poashtu duhet formuar edhe komisionin i cili e monitoron tërë këtë proces.

12. Të ndryshme:

a. Shqyrtimi i propozim-vendimit për transfer të mjeteve buxhetore;

b. Shqyrtimi i propozim-marrëveshjes, të paraqitur nga OJQ “Grupi Lokal i Veprimit - Vicianarural”;

c. Shqyrtimi i kërkesës së OJQ “Çeshme” për ndihmë materiale për pjesëmarrje në një festival në Turqi;

Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të AAK-së e mbështet propozim-vendimin për transfer të mjeteve buxhetore. Gjithashtu mbështet edhe kërkesën e OJQ “Çeshme”, por nuk e mbështetin kërkesën e OJQ “Vicianarural” pasi që është konflikt interesi, sepse drejtori i OJQ-së në fjalë është udhëheqës i një sektori në Komunën e Vushtrrisë.

Veli Karaça, anëtar i Kuvendit- duke iu referuar kërkesës së OJQ “Vicianarural”, tha se kjo OJQ i paska orientuar mjetet në një rrugë që kishte me ndihmuar një popullatë me shumë halle (probleme) të cilët bëjnë rrugë shumë të gjatë për të ardhur në Vushtrri. Pastaj tha se nuk e vlerëson se ekziston konflikt interesi, pasi që ky Grup Lokal i Veprimit që është i Vushtrrisë nuk mund të fiton grante për qytete tjera, por këta sjellin donacione për Komunën e Vushtrrisë.

Esat Beka, anëtar i Kuvendit- pyeti pse ky vendim për transfere të mjeteve buxhetore të komunës, duke kërkuar arsye bazë, dhe kërkoi llogaridhënie nga ata që e kanë shkaktuar këtë dëm ndaj buxhetit të komunës.

Besim Jashari, anëtar i Kuvendit- paraqiti shqetësimin e tij në lidhje me rastin e humbjes së kontestit në gjykatë, me ç'rast komuna me humbjen e këtij kontesti ka humbë një shumë të konsiderueshme të mjeteve, dhe me këtë është cenuar interesi i përgjithshëm i qytetarëve, dhe vazhdoi duke thënë që nuk është hera e parë që Komuna e Vushtrrisë humbë konteste gjyqësore, dhe pas humbjeve të kontesteve, në asnjë rast nuk ka llogaridhënie dhe përgjegjësi. Gjithashtu tha se shuma e humbur prej 53.000 € për buxhetin e Komunës së Vushtrrisë, si një komunë e vogël dhe me një buxhet modest, është humbje e madhe, duke shtuar se me këtë shumë të humbur, do të mund të realizoheshin shumë projekte në favor të banorëve të jetojnë në vise të thella, siç është Ashlani, Gumnishta, Vesekofci dhe Kurillova. Në fund kërkoi nga Kryetari i Komunës që të marrë masa përgjegjësie dhe të kërkon llogari pse komuna e ka humbur këtë kontest dhe në këtë mënyrë është cenuar buxheti i komunës në shumën në fjalë.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i Kuvendit- Grupi parlamentar i PDK-së shpreh shqetësimin për humbjen e këtyre mjeteve, mirëpo kjo është pasojë e pushtetit të kaluar, dhe shtoi se i përkrahin propozim-vendimet në fjalë, kurse për OJQ-në “Çeshme” kërkoi që t’i ndahen 2.000 €.

Pajazit Pllana, anëtar i Kuvendit- lidhur me projektin e OJQ-së “Vicianarural” pyeti se sa mund të realizojnë me këto mjete një gjatësi afër 10 kilometra, dhe a mund të realizohet me këto mjete?

Xhemajl Pllana, anëtar i Kuvendit- lidhur me kontestin e humbur nga ana e komunës, fajësoi administratën komunale për humbjen e kontestit prej 53.000 €, ngase me kontratë kanë qenë të rregulluara të gjitha të drejtat dhe kufizimet e biznesit përfitues. Për më keq, ky biznes nuk iu ka përmbytur rregullave të punës, p.sh. organi i punës ka qenë i përcaktuar në përputhje me orarin e punës së shkollës, ndërsa biznesi në fjalë i ka thyer këto rregulla duke punuar deri në orët e vona të natës, bile ka pasur raste të ndryshme të incidenteve, ku është rrezikuar jeta e qytetarëve, prandaj në vend se të ndëshkohet biznesi, është gjobitur komuna, pra kjo është e pajustificueshme, dhe i vjen era keqpërdorim dhe korrupsion. Pastaj lidhur me grantin e fituar nga USAID-i tha se do të ishte mirë që me ato mjete ta zgjedhim problemin e teknikës së kuvendit. Në fund kërkoi që në rendin e ditës në mbledhjen e ardhshme të KK-së të shtrohen ndërtimet pa leje, dëmtimi i tokave bujqësore, i lumenjve, pyjeve dhe ambientit tonë.

Ergin Sunguri, anëtar i Kuvendit- duke arsyetuar kërkesën e OJQ-së “Çeshme”, tha se do të udhëtojnë 30 vetë për në Turqi, pastaj do të ketë udhëtime (vizita) të shumta brenda Turqisë, dhe qëndrimi atje do të jetë një 10 ditor.

Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit- kërkoi që të ngritet një hetim për të gjitha kontestet e humbura të komunës prej pas luftës, e deri më sot.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- lidhur me kërkesën e OJQ-së “Vicianarural” tha se ia vlen që komuna t’ua jep 3.000 €, pasi që e njëjta OJQ i ka përfituar si donacion 7.000 € nga MBPZHR-ja, mirëpo komuna do ta mbikëqyrë realizimin e atij projekti. Gjithashtu tha se shumica e komunave kanë OJQ të tilla brenda komunës. Mandej njoftoi se gjyqi në formën e prerë në të gjitha nivelet ka marrë vendimin që Komuna e Vushtrisë është dënuar me 53.000 €, dhe vendimi ka shkuar në Ministrinë e Financave për ekzekutim, duke shtuar se këto të holla ua kanë hequr nga mallrat dhe shërbimet. Gjithashtu tha se me shkrim iu ka drejtuar policisë për të bërë hetime për rastin në fjalë. Kurse lidhur me kërkesën për ndihmë nga OJQ “Çeshme”, tha se e mbështet kërkesën në fjalë për t’iu ndihmuar.

Në fund të diskutimit lidhur me këto nënpika të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim mjetet buxhetore të komunës nga programet buxhetore të mjeteve të lira buxhetore të projekteve kapitale në shumë prej 58,000.00€ të transferohen nga këto programe buxhetore:

a) Nga Drejtoria e Administratës, kodi i programit 163

- Projekti, Renovimi objektit të komunës, kodi ekonomik (83122), shuma 25,000.00 €,***
- Orendi për zyre në administratën e komunës, kodi ekonomik (83119), shuma 3,000.00€, dhe***

Nga Drejtoria për Planifikim urban dhe mjedis, kodi i programit 660

- Mbikëqyrja e projekteve, kodi ekonomik (83136), shuma 20,000.00€.***

Nga Drejtoria për Kulturë rini dhe sport, kodi i programit (850)

- Restaurimi i shtëpisë së Mahmut Agë Gjinollit, kodi ekonomik (83147), shuma 10,000.00€.***

b) Këto mjete transferohen në mallra dhe shërbime në këto programe buxhetore:

- Administrata dhe personeli kodi i nën programit (16324), shuma 4,115.63 €,***
- Shërbime publike, mbrojtje civile dhe emergjencë kodi i nën programit (18024), shuma 35,746.63€,***

- **Inspeksion kodi i programit (166), shuma 10,548.00€,**
- **Zyra e Komuniteteve kodi i programit (195), shuma 3,646.73€,**
- **Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi rural, kodi i nën programit (47024), shuma 3,942.95€.**

Me këtë vendim lejohen mjete financiare nga buxheti i komunës, në shumë prej 3.000. € (tremijë euro) për realizim të projektit “rregullimi i rrugës Vese koc – Skromë” financim i përbashkët me OJQ “Vicianarural” me seli në Vushtrri.

Me këtë vendim lejohen mjete financiare nga fondi për subvencione në llogari të OJQ “Çeshme” në Vushtrri, në shumën prej 3.500 € (tre mijë e pesëqind euro), për udhëtim dhe pjesëmarrje në një festival në Turqi.

Obligohet Dreitoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale që të lidhë marrëveshje me përfituesin e këtyre mjeteve, i cili do të hartoj raport për mjetet e shpenzuara në shumën e cekur si në nenin paraprak.

ç. Informatë në emër të përfaqësueseve femra-deputete të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë.

Xhylsime Feka, anëtare e Kuvendit- njoftoi se është mbajtur një takim me anëtarët ferma-deputete të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë, me ç’rast është formuar Grupi joformal i tyre. Grupi joformal i grave të Vushtrrisë është formuar konform Ligjit për barazi gjinore, dhe tha se ky grup do të funksionoi në baza vullnetare dhe të mirëkuptimit, dhe si qëllim do të ketë fuqizimin e rolit të gruas në pozitë vendimmarrëse, politike dhe sociale, duke u munduar që ta ngris nivelin e përgjegjësisë dhe vetëdijësimit karshi sfidave kur vjen në pyetje meritokracia. Pastaj tha se Grupi në fjalë nuk do të funksionoi në baza partiake, por të bashkëpunimit të mirëfilltë në baza të shëndosha dhe të arsyes intelektuale. Kurse në aspektin e bashkëpunimit, tha se do të përqipemi që të kemi bashkëpunim edhe jashtë përbërjes së Kuvendit, që nënkupton bashkëpunim me të gjitha OJQ-të që funksionojnë në komunë dhe rrjetet e ndryshme legale, në mënyrë që të jetë një punë e frytshme në aspektet sociale, dhe problemeve të ndryshme që preokupojnë gruan. Në vazhdim njoftoi se Grupi në fjalë do të ketë edhe rregulloren e vet, në bazë të së cilës do të funksionoj. Në fund njoftoi se është formuar kryesia, duke u zgjedhur kryetare Xhylsime Feka, ndërsa nënkryetaret janë Bahrije Pllana dhe Vlora Qirezi, kurse zëdhënëse e Grupit joformal është zgjedhur Melihate Basholli.

d. Pyetjet eventuale të anëtarëve të Kuvendit.

Sabri Ferati, anëtar i Kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të AAK-së kërkoi nga Kryetari i Komunës që të rritet fondi për bashkëfinancim, me qëllim të rregullimit të disa rrugëve me kubëza.

Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit- kërkoi që në seancën e ardhshme të kuvendit të diskutohet për raportin e auditorit lidhur me pasqyrat financiare të komunës për vitin 2010, si dhe kërkoi që t’iu dërgohet nga një kopje e versionit final të buxhetit të vitit 2011, i cili është aprovuar.

Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit- kërkoi që në seancën e radhës të kuvendit të silltet një kopje e raportit e auditorit të përgjithshëm, si dhe pyeti lidhur me ndërtimet që po bëhen në zonën urbane tek “Ura e Gurit”, duke shtuar se a kanë leje pune dhe a po respektohet plani urban. Gjithashtu pyeti se a ka leje ndërtimore kompania “Toni Company” për ndërtimin e seperacionit për shfrytëzimin e zallit, rërës dhe gurëve, duke kërkuar përgjigje me shkrim për çështjen në fjalë. Në fund pyeti se kush e mori vendimin për lejimin e mjeteve për organizimin e darkës për personelin arsimor, i cili ishte motivi dhe çmimi i darkës në fjalë.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- njoftoi se i ka propozuar drejtorit të arsimit që organizimi i darkës për mësimdhënësit të futet në planifikim, pasi që do të jetë tradicionale, duke shtuar se darka në fjalë ka kushtuar mbi 9.000 €.

Besim Jashari, anëtar i Kuvendit- duke shprehur shqetësimin për çështjen e sigurisë, tha se para disa ditëve në Vushtrri ka ndodhur një rrahje masive në mes të të rinjëve, në cilën ka pasur të lënduar, dhe nga policia janë konfiskuar 5 armë të tipit TT, prandaj kërkoi nga kryetari që në bashkëpunim me organet policore të ngrisin nivelin e sigurisë, sidomos gjatë periudhës së verës, kur dihet që gjatë kësaj kohe është një fluks i bashkatdhetarëve nga jashtë. Pastaj në mesin e muajit korrik të vitit të kaluar është vendosur gurthemeli i Kullës së Azem Galicës, prandaj pyeti drejtorin e kulturës dhe Kryetarin e Komunës, se deri ku kanë shkuar punimet për ndërtimin e Kullës së Azem Galicës në fshatin Galicë, a ka ngecje në këto punime, cili është afati, si dhe kur mendohet që të përfundohet ky projekt?

Habib Mustafa, anëtar i Kuvendit- pyeti Kryetarin e Komunës se deri ku kanë shkuar përgatitjet për ndërtimin e Urës mbi lumin “Sitnicë” në fshatin Gurakuq dhe a do të ndërtohet ura në fjalë në këtë vit?

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- sa i përket pyetjes lidhur me ndërtimin e urës, tha se janë siguruar 500.000 €, nga Ministria e Financave, prej tyre 450.000 € për ndërtimin e Urës në fshatin Prelluzhë, kurse 50.000 € për infrastrukturë në të njëjtin fshat, duke shtuar se për çështjen e ndërtimit të Urës në Prelluzhë ka diskutuar edhe me gjeneralin e KFOR-it, dhe i njëjti ka shprehur gatishmërinë e tij për të ndihmuar që Ura të ndërtohet pa probleme, dhe me iniciativën e tij është organizuar një takim në Prelluzhë me këshillin e fshatit dhe Kryetarin e Komunës, dhe janë pajtuar që ura të ndërtohet, me kushtin që të realizohen edhe disa projekte në atë fshat. Në vazhdim njoftoi për realizimin e disa projekteve në fshatin Prelluzhë. Gjithashtu njoftoi se në fillim të muajit të ardhshëm do të shpallet tenderi për ndërtimin e Urës në fshatin Prelluzhë. Mandej duke iu referuar çështjes së sigurisë të ngritur nga B.Jashari, tha se siguria e komuniteteve në Vushtrri është e mirë, kurse shqetësuese që në mesin e shqiptarëve po ndodhin rrahje në mes të grupeve për interesa të ndryshme. Kurse sa i përket pyetjes lidhur me punimet për Kullën, tha se Kulla e Azem Galicës është duke u ndërtuar, por ka pasur edhe vërejtje që nuk është punuar mirë, por tani janë duke shkuar punimet shumë mirë.

Mbledhja përfundoi në orën 16:10.

Procesmbajtësi:
Albanez Tahiraj

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi